

Bauar në Urdherin **Nr.506** datë **18.09.2013** “Për ndalimin e procedurave të marrjes dhe largimit nga puna të punonjësve dhe dhënien me qera të ambjenteve dhe hapsirave, në institucionet shëndetësore” në bazë të Urdherit të Ministrit të Shëndetësisë Nr.511, datë 13.12.2011 “ Për kriteret e punësimit në shërbimin shëndetësor publik” , në zbatim të VKM-së **Nr.176 datë, 29.03.2006 "Për botimin e buletinit të njoftimeve publike "** dhe , Urdherit të Ministrit të Shëndetësisë **Nr.84** datë, **04.03.2014** "Miratimin e Kriteve të punësimit në Klinikën Stomatologjike Universitare “ kërkojmë të botohet njoftimi për vëndin e lirë të punës si më poshtë:

Klinika Stomatologjike Universitare njofton shpalljen e vëndit vakantë në pozicionin Mjek/e Ordinator/e në Shërbimin e Terapisë . Personat e interesuar duhet të plotësojnë këto kriterë:

- 1.Kandidati duhet të ketë mbaruar studimet e larta në degen e Stomatologjisë në një fakultet me program të akredituar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.
- 2.Për kandidatet që kanë studiuar jashtë vëndit,diploma e tyre duhet të jetë njohur nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.
- 3.Të ketë mbaruar studimet e larta me notë mesatare mbi 8

Vlerësimi i notës mesatare:

-Mbi notën mesatare 9 vlerësohet me 15 pikë

-Mbi notën mesatare 8 vlerësohet me 12 pikë

- 4.Të ketë mbrojtur me notë mesatare mbi 8 një gjuhë të huaj,preferohet anglishtja.Cdo gjuhë e huaj vlerësohet me 3 pikë.

- 5.Të zotërojnë në nivel të kënaqshëm përdorimin e kompjuterit në programet Word,Exel,Power Point etj.

- 6.Të ketë veprimtari botuese në shtypin shkencor,kur stazhi i tij pas diplomimit e mundëson një gjë të tillë.

- 7.Të ketë aftësi referime si autor/e në Konferenca Kombëtare dhe Ndërkombëtare.

8. Të ketë aftësi të mira komunikuse me pacientët, studentët dhe stafin e Klinikës.
9. Të jetë i motivuar për të punuar në një institucion shëndetësor të nivelit terciar dhe me kërkesa të larta në punën studimore-shkencore dhe në aktivitetin profesional e pedagogjik të institucionit.
10. Të ketë stazh pune mbi 2 vjet pas diplomimit.
11. Të ketë te paktën një Specializim /Master në fushat e Stomatologjisë.
12. Të ketë Licence minimalisht 3 vjet.
13. Titulli shkencor dhe grada vlerësohen me 20 pikë.
14. Intervista maksimalisht vlerësohet me 10 pikë.

Personat e interesuar do të sjellin pranë protokollit të Klinikës Stomatologjike Universitare dokumentat si më poshtë :

- I. Leja e Ushtrimit të Profesionit.
- II. Kërkesë me shkrim/Letër motivimi;
- III. Jetëshkrim (CV) të përditësuar, *(ku të përfshihen të dhënat e kontaktit – numër telefoni/e-mail);*
- IV. Diplomat e shkollës së lartë, listat e notave /fotokopje të njehsuara me origjinalin. *(Diplomat dhe dokumentacioni që vërteton arsimimin akademik, të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi);*
- V. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet e saj, që vërtetojnë eksperiencën në punë)/vërtetim të periudhave të punësimit nga sigurimet shoqërore;
- VI. Fotokopje të letërnjoftimit (ID-së) ;
- VII. Raport mjekësor për aftësinë në punë/vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- VIII. Dëshmi penaliteti;
- IX. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe të kualifikimeve, specializimeve, arsimimin shtesë, trajnimet, vlerësimet dhe referencat e mundshme, si dhe ato, që vërtetojnë faktet e tjera të përmendura nga aplikanti në jetëshkrim.
- X. Vërtetim banimi.
- XI. Certifikatë personale dhe familjare.
- XII. Vlerësimin e fundit nga eprori i drejtëpërdrejtë *(nëse ka).*
- XIII. Vërtetim nga institucioni ku punon, që nuk ka masë disiplinore në fuqi *(nëse ka).*
- XIV. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe të kualifikimeve, specializimeve, arsimimin shtesë, trajnimet, vlerësimet dhe referencat e mundshme, si dhe ato, që vërtetojnë faktet e tjera të përmendura nga aplikanti në jetëshkrim.

Dokumentet mund të jenë origjinale apo të njehsuara me origjinalin.

Dokumentet e përfutuara në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të njehsuara sipas ligjit.

(Dokumentacioni duhet të jetë origjinal ose fotokopje e noterizuar, mosparaqitja e plotë e dokumentacionit sjell skualifikim të kandidatit).

Aplikimi dhe dokumentacioni përkatës dorëzohen/dërgohen në Zyrën e Arkivë-Protokollit të KSU, në adresën Rr.Dibres Brenda QSUT ,Tiranë deri në datën 18/7/2025 (brendaorarit zyrtar), sipas një formati i cili përshkruan të gjithë dokumentacionin në dosje të aplikantit dhe firmoset nga specialisti i Protokollit-Arkivës, që merr në dorëzim kërkesën dhe aplikanti përkatës.

Aplikantët që plotësojnë kriteret, nëpërmjet aplikimit dhe dokumentacionit përkatës, njoftohen individualisht

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve :

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar, lidhur me kriteret, përvojën dhe kualifikimet e lidhura me fushën e pozicionit të punës, si dhe gjatë intervistës me gojë lidhur me njohuritë mbi fushën, aftësitë, eksperiencën e mëparshme, kompetencën, motivimin dhe pritshmëritë në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës.

Totali i pikëve është 40 pikë.

Dalja e rezultateve të konkurimit dhe komunikimi i tyre

Fituesi do të njoftohet edhe nëpërmjet kontakteve të shënuara në aplikimin e paraqitur nga ana e këtij të fundit.

Për çdo paqartësi mund të dërgohet e-mail në adresën KSU@shendetesia.gov.al